

AMF vijon aktivitetin në kushtet e pandemisë COVID-19

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-mars 2020
- Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2020
- Zhvillimet e Tregtimit në Bursën ALSE për periudhën janar-mars 2020

Zhvillime të tjera

- Miratohet projektligji “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”

Botime Profesionale

- “Bankieri” - Tregu i sigurimeve pas tërmetit dhe nevoja e edukimit financiar, Aranit Muja (Aktuar, AMF)
- “Revista mbi Pensionet dhe Financat” – abstrakte të përzgjedhura
- “Revista mbi Menaxhimin e Riskut në Institucionet Financiare” - titujt kryesorë

Lajme Ndërkombëtare

- Bosnje-Hercegovinë
- Bullgari
- Kroaci
- Rumani
- Slloveni

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

AMF vijon aktivitetin edhe në kushtet e pandemisë COVID-19

I nderuar lexues,

Ky periodik informativ i AMF-së vjen në kushtet kur Shqipëria, si vendet evropiane dhe e gjithë bota po përballet me krizën pandemike të shkaktuar nga virusi COVID-19. Prania e këtij virusi ka kërkuar zvogëlimin e kontakteve fizike dhe zhvillimin e punës në rrethana të reja sociale dhe ekonomike. Këtyre kushteve të reja i është përshtatur edhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre në tregjet financiare jobankare.

AMF ka vijuar punën *online* ndërkohë që shërbimet telefonike dhe të komunikimit me e-mail kanë qenë efektive përgjatë gjithë kohës. AMF ka vijuar komunikimin me shoqëritë që veprojnë në tregjet financiare jobankare, si edhe me publikun e gjerë duke realizuar kështu misionin e saj për mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregjeve dhe mbrojtjen e konsumatorit. Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatore në AMF është aktive dhe të gjithë konsumatorët e kanë mundësinë të përcjellin dhe të informohen më tej në komunikim me stafin e saj.

Situata e pandemisë COVID-19 ka nxjerrë më tej në pah rëndësinë e veprimeve të përbashkëta si me autoritetit e vendit dhe organizmat ndërkombëtarë ku AMF është anëtare. Mbështetur edhe në rekomandimet e Autoriteti Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), si edhe rregullatorëve të tjerë homologë, AMF në mbledhjen e datës 10 prill 2020 miratoi vendimin e pezullimit të shpërndarjes së dividendit nga shoqëritë e sigurimit si edhe marrjen e masave për kujdes të shtuar me qëllim ruajtjen e likuiditetit dhe treguesit e tyre financiarë. Pezullimi i shpërndarjes së dividendëve dhe ndjekja e një politike më të kujdesshme në lidhje me shpërblimet e stafit, duke i shtyrë ato në kohë, rrit aftësinë e shoqërive të sigurimit për të amortizuar pasojat e shkaktuara nga situata e COVID-19.

Gjithashtu Bordi i AMF-së miratoi vendimin për kontribuimin në fondin anti COVID-19 duke ulur me 50% shpërblimin mujor për Kryetarin dhe anëtarët e Bordit të Autoritetit dhe pagat mujore të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Nëndrejtorit Ekzekutiv për një periudhë 3-mujor.

AMF mbetet e angazhuar për një mbikëqyrje efektive në funksion të mbrojtjes së konsumatorit dhe investitorit si edhe për ruajtjen e stabilitetit financiar.

AMF është e ndërgjegjshme që shëndeti publik dhe rigjallërimi i ekonomisë do të ecin paralelisht me qëllim sigurimin e mirëqenies progresive, të shëndetshme, gjithëpërfshirëse për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Situata e pandemisë COVID-19 ka nxjerrë më tej në pah rëndësinë e veprimeve të përbashkëta si me autoritetit e vendit dhe organizmat ndërkombëtarë ku AMF është anëtare.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-mars 2020

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-mars 2020 kapën vlerën mbi 3,590 milionë lekë, ose 9.56% më pak se në periudhën janar-mars 2019. Gjatë periudhës janar-mars 2020, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 240,514 me një ulje prej 12.86% krahasuar me periudhën janar-mars 2019.


Në këtë ulje të volumit të primeve të shkruara bruto dhe numrit të kontratave në tremujorin e parë 2020, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, vlerësohet të ketë influencuar edhe gjendja e pandemisë globale. Shpallja e saj, e cila u shoqërua me vendimet për distancim social dhe mbylljen e lëvizjeve dhe solli që edhe për disa nga klasat e sigurimit si Kartoni Jeshil, Sigurimi Kufitar, Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit në Udhëtim të kenë pësuar zbritje të ndjeshme të numrit të kontratave të lidhura.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.59% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 7.41%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 41.95% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 58.05% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-mars 2020, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 2,263 milionë lekë, ose 50.88% më shumë se në periudhën janar-mars 2019.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-mars 2020 kapën vlerën mbi 3,590 milionë lekë, ose 9.56% më pak se në periudhën janar-mars 2019. Gjatë periudhës janar-mars 2020, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 240,514 me një ulje prej 12.86% krahasuar me periudhën janar-mars 2019.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-mars 2020 (Në %)




Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2020

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2020, u dominua në masën 77.20% në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe 22.80% nga transaksionet në instrumente afatgjatë (obligacione). Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 90.61% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2020, flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 45.16% dhe 40.05% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, për periudhën janar-mars 2020 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.79% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Letra me vlerë të Qeverisë, janar-mars 2020 (Në %)



Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, për periudhën janar-mars 2020 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.79% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-mars 2020, ka pasur një ulje prej 2 miliardë lekë ose 65.13% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Ndërkohë edhe numri i transaksioneve është ulur në masën 6.58%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-mars 2020, ka pasur një rritje prej 29 milionë lekë ose 4.69%, ndërkohë pati një ulje në numrin e transaksioneve në masën 29.20%, krahasuar me periudhën janar-mars 2019. Vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 1.98 miliardë lekë, krahasuar me periudhën janar-mars 2019.

Tregtimi i titujve në Bursën ALSE për 3-mujorin e parë 2020

Sipas të dhënave statistikore të Bursës ALSE, gjatë 3-mujorit të parë të 2020, në këtë bursë janë tregtuar Bono Thesari në vlerën 118,908,131 lekë dhe Obligacione Thesari në vlerën prej 107,838,610 lekë. Duke analizuar volumin për njësi të tregtuara, numrin e transaksioneve dhe vlerën e tregtuar, gjatë këtij 3-mujori, kanë dominuar transaksionet off-exchange.

Nga të dhënat e tregtimit në ALSE, për 3-mujorin e parë të 2020, sipas llojit të transaksioneve, kanë dominuar në volum, vlerë dhe numër, transaksionet e ekzekutuara për llogari të klientëve.

Tregtimi i Titujve të Qeverisë të R.Sh. në Bursën ALSE		
Lloji i Transaksionit	Vlera e Tregtimit (Në Lekë)	
	Bono Thesari	Obligacione Thesari
Për Anëtarët	4,182,520	666,060
Për Klientët	114,725,611	107,172,550
Individë	15,345,611	12,036,750
Persona Juridikë	99,380,000	95,135,800
TOTAL	118,908,131	107,838,610

Miratohet projektligji “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”

Kuvendi i Shqipërisë miratoi më 30 prill 2020, në seancë plenare projektligjin "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive". Ky ligj siguron bazën e nevojshme legislative për zhvillimin e mëtejshëm të tregut të fondeve të investimeve në vend. Projektligji synon:

Kuvendi i Shqipërisë miratoi më 30 prill 2020, në seancë plenare projektligjin "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive". Ky ligj siguron bazën e nevojshme legislative për zhvillimin e mëtejshëm të tregut të fondeve të investimeve në vend.

- Harmonizimin e kërkesave për themelimin e sipërmarrjes me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur ose me intervale (të cilat duhet të kenë shoqëri administruese dhe depozitar), në përputhje me kërkesat e Direktivës e Bashkimit Evropian për UCITS, pavarësisht nëse fondi është sipërmarrje e investimeve kolektive apo fond i investimeve alternative;
- Forma të reja organizimi, siç janë fondet e investimeve alternative, të cilat, përkufizohen si të gjitha llojet e fondeve, investimet e të cilave nuk përputhen me përcaktimet e Seksionit III të Kapitullit VII për Sipërmarrjet e Investimeve kolektive në tituj të transferueshëm (UCITS), si dhe tipe të reja fondesh, në përputhje me direktivën (AIFMD);
- Rritjen e mbrojtjes së investitorit përmes rritjes së kërkesave në lidhje me kategorizimin e investitorëve në profesionistë, të kualifikuar dhe jo profesionistë, vlerësimin dhe llogaritjen e çmimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike dhe dhënien e informacioneve shpjeguese;
- Ofrimin e më shumë dispozitave në lidhje me bashkimin dhe shkrirjen e fondeve, si dhe për ruajtjen, likuidimin dhe mbylljen e fondeve dhe të shoqërive administruese e të depozitarëve.

Projektligji është hartuar duke pasur parasysh dy direktiva kryesore të Bashkimit Evropian, Direktivën e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive në Tituj të Transferueshëm (UCITS) si edhe Direktivën e Administratorëve të Fondeve të Investimeve Alternative (AIFMD).

Puna për hartimin e ligjit të ri në fushën e sipërmarrjeve të investimeve kolektive nisi që në vitin 2016 me Projektin “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”. Projekti u financua nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe u mbështetet nga Banka Botërore. Si pjesë e projektit, AMF u mbështet nga ekspertët e kompanisë "Cadogan Financial" që në fazën e dytë të projektit kishin në fokus shqyrtimin dhe zhvillimin e legjislacionit dhe kuadrit mbikëqyrës për tregun e fondeve të investimeve dhe letrave me vlerë.

Projektligji kaloi një fazë të gjerë konsultimi me grupet e interesit, gjatë së cilës u zhvilluan takime të përbashkëta me ekspertët, grupe pune dhe *workshope* edhe me ekspertët e huaj.

Tregu i sigurimeve pas tërmetit dhe nevoja e edukimit financiar

Aranit Muja

Aktuar, AMF

Publikuar në revistën Bankieri

Viti 2019 paraqiti disa sfida në tregun e sigurimeve në vend. Ndër to veçohen tërmetet e 21 shtatorit dhe 26 nëntorit. Tërmeti i 26 nëntorit, më i forti kishte një magnitudë 6.4 i shkallës Rihter dhe specialistët e cilësuan si më i forti i 40 viteve të fundit. Këto dy tërmete e vunë tregun e sigurimeve përballë kërkesave të mëdha për dëmshpërblim. Kërkesat për dëmshpërblim që janë trajtuar nga tregu i sigurimeve deri tani janë 5,129 dhe arrijnë vlerën 29 milion euro. Nga kjo vlerë shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri do të paguajnë 1.8 milion euro, ndërsa diferenca do të paguhet nga shoqëritë risiguruese, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Referuar numrit të dëmeve të raportuara, në linjë me pronat e siguruara, vihet re, që rreth 85% e tyre i përkasin të siguruarve të cilët kanë siguruar pronën për efekt kredie, ndërsa pjesa tjetër janë prona të siguruara në mënyrë vullnetare, përfshirë këtu dhe objektet shtetërore si universitetet, spitalet, etj.

Në funksionin e tij rregullator mbi tregun e sigurimeve, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), në bashkëpunim me grupet e interesit, ka hartuar ligjin e ri që rregullon tregun e sigurimeve, i cili është miratuar në vitin 2014. Ligji 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", nga pikëpamja e menaxhimit të rrezikut, ndër të tjera, parashikon që shoqëritë e sigurimit duhet të risigurojnë të gjitha rreziqet që tejkalojnë 10% të aftësisë paguese. Me Rregulloren nr. 85/1, datë 30.09.2015 "Për kriteret e risigurimit", të ndryshuar, AMF ka përcaktuar cilësinë e risiguresve me të cilët duhet të nënshkruajnë kontratat e risigurimit shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin e sigurimit në Republikën e Shqipërisë. Cilësia e risiguresve që mbulojnë aktualisht shoqëritë e sigurimit është A+ e lart, sipas agjencive klasifikuese Standard & Poors, AM Best, Fitch, etj. Për ngjarjet e tërmetit, duke qenë ngjarje me probabilitet të ulët, por me ndikim të lartë në rast ndodhjeje, AMF gjithashtu ka miratuar me rregullore metodologjinë e llogaritjes së normës së mbajtjes agregate neto për sigurimin nga tërmeti (NST) për shoqëritë e sigurimit. Nga vitit 2014 dhe në vijim, AMF e mbikëqyr tregun e sigurimeve sipas metodologjisë me bazë rreziku.

Duke vrojtuar treguesit e shoqërive të sigurimit, vihet re se tregu i sigurimeve e përballoi me sukses faturën financiare të dëmeve të ndodhura nga dy ngjarjet e tërmetit duke e ndarë edhe me shoqëritë e risigurimit këtë faturë financiare.

Referuar numrit të dëmeve të raportuara, në linjë me pronat e siguruara, vihet re, që rreth 85% e tyre i përkasin të siguruarve të cilët kanë siguruar pronën për efekt kredie, ndërsa pjesa tjetër janë prona të siguruara në mënyrë vullnetare, përfshirë këtu dhe objektet shtetërore si universitetet, spitalet, etj.

Strategjia e AMF-së përfshin një fushatë informuese, takime e orë të hapura leksionesh në universitete publike e private në vend, mundësimin e praktika mësimore të studentëve pranë Autoritetit dhe subjekteve nën mbikëqyrje, si edhe kryerjen e anketimeve për të matur nivelin e njohurive financiare te popullsisë.

Në mënyrë që mbulimi në sigurim i këtyre rreziqeve të vazhdojë me sukses është e domosdoshme rritja e numrit të rreziqeve të siguruar nga tërmeti, në formë vullnetare apo të detyrueshme. Aktualisht ky numër vlerësohet në nivelin e 3%, nivel i cili gjykohet shumë i ulët për të përfituar në prime më të ulta nga risiguruesit, të cilët do të reflektoheshin në konsumatorin final.

Në funksion të mbrojtjes konsumatore dhe zhvillimit të tregut të sigurimeve, në linje me disa vende me rrezik të lartë sizmik si Turqia apo Rumania, Banka Botërore, ka rekomandua kalimin në sigurim të detyrueshëm të ndërtesave rezidenciale nga tërmeti. Kjo sigurisht kërkon që tarifat e sigurimit të jenë të përballueshme nga të gjithë qytetarët dhe të garantohet një vlerë baze dëmshpërblimi për njësi banimi dhe për vlera më të larta të qëndrojnë sigurimi vullnetar. Nëse vihet në zbatim, sigurimi i detyrueshëm rrit penetrimin e sigurimit, dhe do kemi një ulje në përqindje të shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe atyre administrative, ulje të primit të risigurimit si dhe ulje të tarifës për njësi banimi që do të paguhet nga qytetarët. Në tërësi sigurimi i detyrueshëm, ofron kushtet për një mbrojtje më të mirë të të siguruarve në një vend me ekspozim të lartë nga tërmetet si Shqipëria.

Edukimi financiar i publikut gjykohet nga Autoriteti si një faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e tregut të sigurimeve. Nëpërmjet rritjes së njohurive dhe ndërgjegjësimit të publikut rreth produkteve të ofruara nga tregu i sigurimeve, do të rritet besimi i konsumatorit duke kontribuar njëkohësisht në zhvillimin e tregut financiar në përgjithësi. Edukimi i vazhdueshëm financiar do të ndërgjegjësojë konsumatorin në marrjen e vendimeve të drejta dhe të bazuara në informacion e nevojshëm. Në këtë këndvështrim, rezultate më të mëdha do të arrihen nga një bashkëpunim edhe me të gjithë aktorët të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e sigurimeve.

Duke pasur në vëmendje rëndësinë e madhe të edukimit financiar të popullatës, AMF është angazhuar në veprime konkrete për rritjen e besimit dhe edukimit të konsumatorit për tregjet nën mbikëqyrje, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të shumta informuese dhe edukuese për zbatimin e Strategjisë së miratuar nga Bordi i Autoritetit “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje”. Strategjia e AMF-së përfshin një fushatë informuese, takime e orë të hapura leksionesh në universitete publike e private në vend, mundësimin e praktika mësimore të studentëve pranë Autoritetit dhe subjekteve nën mbikëqyrje, si edhe kryerjen e anketimeve për të matur nivelin e njohurive financiare te popullsisë. Gjithashtu Autoriteti ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me pjesën më të madhe të këtyre universiteteve me qëllim bashkëpunimin e mëtejshëm për edukimin e brezit të ri. Çdo vit tashmë është bërë traditë që Autoriteti organizon Konferencën e studentëve për Edukim Financiar për t'i nxitur studentët të hulumtojnë dhe të punojnë për të përmirësuar dijet e tyre për sa i përket tregjeve financiare jobankare.

Një tjetër nismë e ndërmarrë nga Autoriteti është ftesa për angazhimin për bashkëpunim të institucioneve publike si Banka e Shqipërisë, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë etj., për hartimin dhe zbatimin e një strategjie mbarëkombëtare për edukim financiar, duke marrë përsipër detyrime të ndryshme dhe duke angazhuar kapacitetet e brendshme profesionale për edukimin financiar të popullatës duke nisur nga bazat. Konsumatori financiar ka nevojë të mësojë sa më shpejt aq më mirë, në mënyrë që të menaxhojë financat personale, financat e familjes, të ardhurat dhe shpenzimet e përditshme apo të investojë në produktet e ndryshme financiare. Edukimi Financiar duhet të fillojë që nga bankat e shkollës dhe të vijojë përgjatë gjithë jetës.

Journal of Pension Economics and Finance (JPEF) është revistë akademike që përqendrohet në ekonominë dhe financimin e pensioneve dhe të ardhurave nga pensioni. Kjo revistë siguron një forum të vlefshëm dhe me ndikim për debat ndërkombëtar në këto fusha. Revista është bashkë-sponsorizuar nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS) dhe OECD.

<https://www.cambridge.org/core/journals/journal-of-pension-economics-and-finance>

Në këtë numër disa nga artikuj që mund të lexoni:

“Modelimi dinamik i mikrosimulimit të reformave të mundshme të pensioneve në Maqedoninë e Veriut” Blagica Petreski dhe Marjan Petreski


(Dynamic microsimulation modelling of potential pension reforms in North Macedonia)


Për shkak të ndryshimeve strukturore dhe të politikave, deficit i pensioneve në Maqedoninë e Veriut u dyfishua gjatë një dekade dhe tejkaloi ndjeshëm deficitin e buxhetit qendror. Qëllimi i punimit është të shqyrtojë efektet fiskale dhe ato të zhvillimit të disa modeleve të reformës së pensioneve. Autorët kanë ndërtuar modelin e pensionit me mikrosimulim dinamik të MK-PENS dhe kanë simuluar efektet e disa reformave që prekin një palë të interesit dhe disa reforma të kombinuara. Autorët japin edhe disa nga rezultatet që rezultojnë nga studimi i tyre.

“Efektet e karakteristikave të punës në pension” Péter Hudomiet, Michael D. Hurd, Andrew M. Parker dhe Susann Rohwedder

(The effects of job characteristics on retirement)

Së bashku me të dhënat në lidhje me karakteristikat aktuale të punës, të dëshiruar dhe të parashikuar të punës, ky punim përdor një element të ri të të dhënave, probabilitetin subjektiv të kushtëzuar për të punuar në moshën 70 vjeç, për të vlerësuar efektet shkakore të karakteristikave të punës në pension në Shtetet e Bashkuara.





Journal of Risk Management for Financial Institutions

Revista mbi menaxhimin e Riskut në Institucionet Financiare

Artikujt kryesore në Volumi 13/2020, Numri 2 janë:

Editorial: Mësimi nëpërmjet makinerive dhe financat John Hull, Editorial Board Member, Journal of Risk Management in Financial Institutions
(Machine learning and finance)

Opinion: Zbulimi i sinjaleve të fshehura për investime të qëndrueshme duke përdorur Big Data: Inteligjenca artificiale, mësimi nëpërmjet makinerive dhe përpunimi i gjuhës natyrore. Madelyn Antoncic, Managing Partner, Global AI Corporation.
(Uncovering hidden signals for sustainable investing using Big Data: Artificial intelligence, machine learning and natural language processing)

CRD V / CRR II: Një përmbledhje gjithëpërfshirëse e hapit të parë evropian drejt zbatimit të Bazelit IV (Pjesa I) Martin Neisen, Partner, PricewaterhouseCoopers and Hermann Schulte-Mattler, Professor, Dortmund University of Applied Sciences and Arts.
(CRD V/CRR II: A comprehensive synopsis of the first European step towards implementing Basel IV (Part I))

A janë testet e stresit si konkurset e bukurisë? (dhe çfarë mund të bëjmë në lidhje me to). Mario Quagliariello, Director, Economic Analysis and Statistics Department, European Banking Authority.
(Are stress tests beauty contests? (and what we can do about it))

Përdorimi i vlerës së tregut të kapitalit për të sinjalizuar dobësitë e sektorit banker. Will Kerry, Deputy Division Chief, Monetary & Capital Markets Department, International Monetary Fund.
(Using the market value of equity to signal banking sector vulnerabilities)

Si mundën mbikëqyrësit dhe bankat të promovojnë një kulturë të qeverisjes së fortë dhe sjellje etike? Stefan Walter, Director General and Florian Narring, Adviser, Directorate General Micro-Prudential Supervision, European Central Bank, Germany.
(How can supervisors and banks promote a culture of strong governance and ethical behaviour?)

Adresimi i rrezikut kibernetik në institucionet financiare dhe sistemin financiar. Allan D. Grody, President, Financial InterGroup Advisors
(Addressing cyber risk in financial institutions and in the financial system)

Bosnje-Hercegovinë

www.xprimm.com

Në vitin 2019, tregu i sigurimeve të Bosnje-Hercegovinës arriti në 390 milionë euro (762.5 milionë BAM, monedha vendase). Siç tregojnë të dhënat e publikuara nga Agjencia e sigurimeve e Bosnje Hercegovinës, AZOBiH, kjo është një rritje prej 7% krahasuar me vitin e kaluar.

Volumi i primeve të shkruara bruto për siguresit që operojnë në Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës u rrit me 6.8% duke arritur në 272 milionë euro, ndërsa siguresit me bazë në Republikën Serbe të Bosnjës siguruan rreth 118 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 7.3%.

Në totalin e primeve të shkruara bruto rreth 20.8% e zë sigurim i Jetës dhe pjesa tjetër nga Sigurimi i Jo-Jetës. Nga klasat Jo-Jetës, vetëm 7.6% e volumit të primeve të shkruara bruto e zë sigurimi i pronës dhe 59.3% sigurimet motorike (Sigurimi Kasko dhe MTPL).

Bullgari

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Komisionit të Mbikëqyrjes Financiare (FSC) të Bullgarisë, siguresit bullgarë arritën një volum të primeve të shkruara bruto për vitin 2019 në vlerën e 2.9 miliardë BGN, monedha lokale ose rreth 1.5 miliardë euro. Kjo shpreh një rritje vjetore prej rreth 15%. Në të njëjtën periudhë, volumi i dëmeve të paguara nga siguresit bullgarë arriti në vlerë prej 620.2 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 8.4% më shumë viti i kaluar, nga të cilat rreth 530 milionë euro ishin të lidhura me sigurimin e Jo-Jetës.

Kroaci

www.xprimm.com

Tërmeti i Zagrebit më 22 mars 2020 me magnitudë 5.5 Rh shkaktoi dëme të vlerësuara në HKR 42 miliardë ose rreth 5.6 miliardë euro. Kjo shifër i referohet përditësimeve më të fundit nga qeveria kroate. Ministri i Ndërtimit dhe Planifikimi Urban Predrag Stromar deklaroi se urgjente është ndërhyrja për riparime të furnizimit me ujë dhe ngrohje si edhe riparimi i shtëpive që njerëzit të kthehen serish në banesa.

Kroacia ka kërkuar ndihmë (financiare) nga Komisioni Evropian dhe Banka Botërore dhe planifikon edhe një konferencë të donatorëve. Në tërmetin e 22 marsit në Kroaci pati një humbje jete ndërsa 27 të tjerë u plagosën rëndë. Shumë duhej të linin shtëpitë e tyre për shkak të dëmeve serioze në strukturat e banesave.

Rumani

www.xprimm.com

Tregu rumun i sigurimeve pati një rritje prej 5.6% në vitin 2019, duke arritur në vlerën e 2.29 miliardë euro. Ritmi i rritjes së sektorit të sigurimit të Jetës ishte 4.7%, ndërsa sigurimet e Jo-Jetës u rritën me 5.87% gjatë vitit 2019.

Tregu i sigurimeve të Jo-Jetës ka pasur zhvillime dhe dinamikë pozitive rritje të primeve të shkruara bruto, duke arritur në vlerën e 1.82 miliardë euro, me rreth 101 milion EUR më shumë sesa në vitin 2018. Rreth 70% e këtij ndryshimi pozitiv u sigurua nga linjat e sigurimeve motorike: Sigurimi Kasko me rritje vjetore 9% dhe sigurimi MTPL rritje vjetore 3,95%. Duhet të theksohet se në sigurimet motorike, ka pasur edhe një rritje prej 14% të dëmeve të paguara. Pagesat e dëmeve u rritën me ritëm më të lartë rritje se primet e shkruara si për sigurimet Kasko ashtu edhe për MTPL.

Gjatë vitit 2019, sigurimi i pronës pësoi rritje prej 7.3% të primeve të shkruara bruto duke arritur në 280.7 milionë euro. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara u rritën shumë me 65.4% krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 77.36 milionë euro.

Slloveni

www.xprimm.com

Sipas raportit të fundvitit të Shoqatës Sllovene të Sigurimeve, tregu slloven i sigurimeve arriti në 2.52 miliardë euro në fund të vitit 2019. Kjo shifër shënon 7.53% më shumë se viti i kaluar. Sigurimi Jo-Jetës përbën 70% të primeve të shkruara bruto, ndërsa pjesa e primeve të sigurimit të Jetës përbënin 30%.

Dëmet e paguara arritën një vlerë të përgjithshme prej 1.64 miliardë euro, nga të cilat rreth 525,33 milionë euro ishin dëmshpërblim për jetën, 514.6 milionë euro ishin për sigurimet e shëndetit dhe 372 milionë euro ishin dëmshpërblime për sigurimet në lidhje me klasa motorike.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al